



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

PROJEKT

**RREGULLORJA
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR KOMPETENCAT,
PËRGJEGJËSITË DHE PUNËN E KOMITETEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
GJILANIT**

Gjiçan, prill 2015

Në bazë të nenit 12.1 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenit 65 paragrafi 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më _____, miraton:

R R E G U L L O R E N

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR KOMPETENCAT, PËRGJEGJËSITË DHE PUNËN E KOMITETEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT 01. NR. 1027 I DT. 29.01.2009

Neni 1

1. Te titulli dhe neni 1 i rregullores bazë, pas fjalës “Komiteteve” shtohet fjalia “jo të përhershme”.
2. Te neni 2 i rregullores bazë, te përkufizimet fjalja në thonjëza “Komitetet” i shtohet fjalia “jo të përhershme”.

Neni 2

1. Te titulli “Qëllimi i themelimit të komiteteve” fshihet fjalia “i themelimit të komiteteve”.
2. Te neni 3 i rregullores bazë, në fillim të fjalisë pas fjalisë “Komitetet” shtohet fjalia “janë themeluar” kurse fshihet fjalia “themelohen”
3. Titulli para nenit 4 “Karakteristikat e përbashkëta” dhe neni 4 i rregullores bazë fshihet.
4. Titulli para nenit 5 të rregullores bazë dhe neni 5 fshihen.
5. Titulli para nenit 6 dhe 7 dhe neni 6 dhe 7 të rregullores bazë fshihen.
6. Titulli para nenit 10 të rregullores bazë, i shtohet fjalia “dhe Agrokulturë” dhe e njëjta të përdoret edhe në tekstin në vazhdim ku është e nevojshme.
7. Te titulli para nenit 12 të rregullores bazë, pas fjalisë “Publike” shtohet fjalia “Banim” dhe në tekstin në vazhdim të përdoret nëse është e nevojshme.
8. Te titulli para nenit 13 të rregullores bazë, fshihet fjalia “dhe çështje gjinore” dhe e njëjta fjali të fshihet nga teksti në vazhdim ku është përdorë.

Neni 3

Titulli para nenit 14 riformulohet dhe ka këtë përmbajtje “Komiteti për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë”, i njëjti riformulim duhet të përdoret edhe në tekstin në vazhdim të rregullores bazë ku është e nevojshme.

Neni 4

Pas nenit 14 të rregullores bazë, shtohet pika 8) si titull me këtë përmbajtje: “Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitar” dhe në nenin 15 aktual të rregullores bazë, bëhet përshkrimi i kompetencave dhe përgjegjësive të komitetit në vazhdim.

Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitar është përgjegjës:

1. mbështet bashkëpunimin ndërkufitarë për çështjet me interes që i preokupojnë qytetarët në të dy anët e kufirit të këtyre Komunave me të cilat kufizohet Komuna e Gjilanit;
2. identifikimi i problemeve të përbashkëta, çështjet dhe objektivat që duhet formalizuar si pjesë e një marrëveshje bashkëpunimi, duke lehtësuar dhe ndihmuar jetën veçmas të fshatrave kufitare të dy anëve të kufirit,
3. shkëmbimi i përvojave për çështje të caktuara me interes të dyanshëm,
4. trajtimi i të zhvendosurve dhe angazhimi për krijimin e kushteve për kthim
5. rekomandimi i çështjeve të caktuara për trajtim dhe zgjidhje në nivel të organeve lokale dhe qendrore që lidhen me çështjen e bashkëpunimit ndërkufitar;
6. angazhimi në respektim të ligjeve të vendit dhe aktet tjera ndërkombëtare që njohin të drejtën e Komunave që të hyjnë në bashkëpunim brenda fushave të tyre të përbashkëta të kompetencës duke u këshilluar me njëri-tjetrin dhe duke nënshkruar marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitarë si në zhvillimin e shkëmbimeve ekonomike, kulturore, lehtësim të kalimeve nga një kufi në kufirin tjetër etj;
7. shqyrton edhe çështje tjera të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, por të cilat delegohen nga organet tjera lokale dhe qendrore.

Neni 5

Pas nenit 15 të rregullores bazë, shtohet pika 9) si titull me këtë përmbajtje: “Komiteti për Barazi Gjinore” dhe në nenin 16 aktual të rregullores bazë, bëhet përshkrimi i kompetencave dhe përgjegjësive të komitetit në vazhdim.

Komiteti për Barazi Gjinore është përgjegjës për:

1. adresim të çështjeve të barazisë gjinore (historike, ekonomike, sociale, kulturore, e politike në nivel lokal);
2. aftësim të kapaciteteve për një vendimmarrje gjithëpërfshirëse brenda komunës,
3. shpërndarje racionale dhe të drejtpeshuar të burimeve njerëzore, materiale e financiare
4. për zbatimin e koordinuar të planit të veprimit për barazi gjinore në komunë;
5. të angazhohet në sigurimin e realizimit të të drejtave të barabarta të grave dhe burrave, të garantuara me kushtetutë dhe ligj;
6. të përcaktojë dhe paraqes masa për promovimin e mundësive të barabarta midis burrave e grave për të eliminuar diskriminimin direkt dhe indirekt, bazuar në gjininë, në jetën publike të vendit;
7. të përcaktojë përgjegjësitë e administratës së komunës për të hartuar politikën për promovimin e një shoqërie gjinore të barabartë dhe
8. shqyrton edhe çështje tjera të cilat lidhen me barazinë gjinore që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore por të cilat delegohen nga organet tjera lokale dhe qendrore.

Neni 6

Pas nenit 16 të rregullores bazë, shtohet pika 10) si titull me këtë përmbajtje: “Komiteti Konsultativ i Ekspertëve të Planifikimit Hapësinorë si trup e jashtme e Kuvendit të Komunës” dhe në nenin 17 aktual të rregullores bazë, bëhet përshkrimi i kompetencave dhe përgjegjësive të komitetit në vazhdim.

Komiteti Konsultativ i Ekspertëve të Planifikimit Hapësinorë si trup e jashtme e Kuvendit të Komunës është përgjegjës:

1. të jep mendime, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit hapësinor (planit zhvillimor komunal, planit zhvillimor urban dhe planeve rregulluese urbane) të cilat i miraton Kuvendi i Komunës.
2. të ofrojë këshilla profesionale në procesin e hartimit të planeve zhvillimore, urbane dhe planeve rregulluese urbane, si dhe në procesin e zbatimit të këtyre planeve
3. shqyrton dhe propozon zgjidhje përkatëse në rastet e jo harmonizimit të strategjive zhvillimore.
4. përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinor të cilat në pajtim me dispozitat ligjore miratohen në Kuvendin e Komunës.
5. kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga fusha e planifikimit hapësinor brenda komunës.
6. shqyrton edhe çështje tjera të cilat lidhen me planifikimin hapësinor të komunës, që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, por të cilat delegohen nga organet tjera lokale dhe qendrore.

Neni 7

1. Neni 17 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni **18**,
2. Te nënparagrafi 17.1 fjalia “zëvendës kryesuesit” zëvendësohet me fjalinë “**anëtari më i vjetër i komitetit për nga mosha**”
3. Neni 18 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni 19,
4. Neni 19 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni 20,
5. Neni 20 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni 21,
6. Neni 21 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni 22,
7. Neni 22 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni 23,
8. Neni 23 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni 24,
9. Neni 24 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni **25** dhe te paragrafi 24.1 këtij neni fjalia “nuk janë organe vendim-marrëse brenda komunës.” Fshihet dhe pas fjalisë ”shqyrtuara” shtohet fjalia “**mund të**”
10. Neni 25 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni 26 dhe fjalia “Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, përkatësisht shërbimi i kuvendit të komunës” zëvendësohet me fjalinë “**Njësia e Kuvendit**”,
11. Titulli para nenit 26 fshihet dhe neni 26.
12. Neni 27 i rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni 26 dhe te paragrafi 27.2 fjala “ 27.1 të kësaj rregulloreje” zëvendësohet me fjalinë “1 të këtij neni”.
13. Neni 28 sipas rregullores bazë, sipas radhës bëhet neni 27 dhe pas fjalës “LVL” vjen “,” dhe pas fjalisë “Statutin e Komunës” shënohet fjalia “dhe aktet tjera nënligjore”

Neni 8

Me miratimin e këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve bëhet pastrimi i tekstit të rregullores aktuale.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. _____
Gjilan, më

Kryesuesja e Kuvendit,

/Valentina Bunjaku-Rexhepi/